



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.457/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Nenad Laziq dhe Rustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses T. M. nga P., të cilin e përfaqëson Avokati Jeton Osmani nga P., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, Sh.A., me seli në P., të cilën e përfaqëson me autorizim F. Sh., për shkak të kompensimit të pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse, përkitazi me revizionin e paditëses, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1024/2022 datë 12.01.2024, pas mbajtjes së seancës së kolegjit më datë 10.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditëses T. M. nga P., paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1024/2022 datë 12.01.2024.

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.456/2021 dt.27.05.2021, aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet e paditura, që paditëses, në emër të tri pagave jubilarë t'ia kompensojë shumën prej 2,564.25 euro, si dhe në emër të përcjelljes në pension t'ia kompensojë tri paga përcjellëse në shumën prej 2,564.25 euro, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim, dt.1.10.2019, e deri në pagesën definitive, të gjitha së bashku në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i aktgjyqimit, nën kërcënim të përbarimit ligjor. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia kompensojë paditëses shumën prej 259.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjyqimit, nën kërcënim të përbarimit ligjor.

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1024/22 dt.12.01.2024, aprovohet si e themeltë ankesa e së paditurës, ndryshohet aktgjykimi i sipër cekur i gjykatës së shkallës së parë, dhe gjykohet si në vijim: Refuzohet kërkesëpadia e paditëses T. M. nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditëses, në emër të tri pagave jubilarë

të ia kompensojë shumën prej 2,5674.25 euro, si dhe në emër të përcjelljes në pension të ia kompensojë tri paga përcjellëse në shumën prej 2,564.25 euro, së bashku me kamatën prej 8%, e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim , dt.1.10.2019, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimeve të procedurës në shumë prej 259.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor, si e pathemeltë. Me pjesën e II të dispozitivit, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja në afat ligjor, ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të aprovohet revizioni (i paditësit F. M. si i bazuar, gabim teknik emri) dhe tutje të anulohet, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet me aprovimin e kërkesëpadsisë së paditësit (sërisht gabim emri i F.M.) si të bazuar dhe detyrohet e paditura që paditësit ti paguajë tri pagat jubilarë dhe tri pagat përcjellëse nga 2564.25 euro, me kamatë prej 8%, nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dt.1.03.2019, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, krejt në afat prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, si dhe pretendimeve të revizionit, ka gjetur se:

Revizioni i paditëses është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, kundër të paditurës, më datën 12.02.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për shkak të kompensimit të tri pagave jubilarë dhe kompensimit të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, me të dhënat tjera si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga kartela e punëtorit për T. M., dt.27.02.2019, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se paditësja ishte në marrëdhënie pune, të pa ndërprerë tek e paditura, nga dt.6.08.1974 deri më dt.1.03.2019, më tepër se 40 vite përvojë pune. Nga pasqyra e pagës për paditësen dt.14.03.2019, është vërtetuar se paga bazë e paditëses (para dorëzimit të padisë) ishte 854.75 euro. Nga marrëveshja për ndërprerjen e kontratës së punës, e lidhur më dt.28.02.2019, në mes të paditurës dhe paditëses, me numër ..., ka vërtetuar se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës dhe me këtë rast paditësja ka marrë pagat e mbetura deri në datën e pensionimit të saj të plotë. Nga leximi i vendimit nr..., dt.23.08.2019, i lëshuar nga e paditura dhe vendimi nr..., i dt.10.04.2019, i lëshuar

nga e paditura, është konstatuar se e paditura e ka njohur punëtorëve të saj të drejtën në kompensimin e pagave jubilarë për periudhën 2015 – 2019. Lidhur me kërkesën për kompensimin e tri pagave përcjellëse për pension dhe vendosjen përkitazi me të, gjykata ka vlerësuar se Kodi i Punës i të paditurës i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, me vendimin Prot.nr..., dt.5.06.2015, përkatësisht neni 51 përcakton si në vijim; “ KEK-u për punëmarrësin që pensionohet pas moshës 65 vjeçare ofron pagesë prej tri pagave bazë mujore”. Gjykata e shkallës së parë, konstaton se pavarësisht faktit se paditësja është pensionuar në mënyrë të parakohshme, të njëjtës duhet t’i takojë ky kompensim.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe në bazë të dispozitës së nenit 52, nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, nenit 4, nenit 90 të Ligjit të Punës, etj, të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka vlerësuar se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, kjo për faktin se, në rastin konkret gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, nga se, sipas nenit 90 të Ligjit të Punës, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë e lidhur për 3 vite, dhe aplikohet nga data 1.01.2015 deri 31.12.2017, kur e njëjta ka pushuar së zbatuari, andaj paditëses, duke pas parasysh edhe vendimin e të paditurës nr..., dt.23.08.2019, nuk i takojnë benefitet nga kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive, nga se e njëjta nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësja ka arritur vitin jubilar për 30 vite, përvojë pune, që i bie viti 2004, respektivisht viti jubilar për 40 vite të përvojës së punës, që i bie viti 2014, ndërkohë që paditësja ka paraqitur padi në gjykatë, më datën 12.02.2021, prandaj, nga këto arsye, duke u bazuar edhe në mendimin juridik të GJSK-së, GJ.A.nr.40/2023 dt.27.02.2023, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, dhe ka vendosur si në pjesën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, sikundër edhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, ndaj, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Aktgjykimi i goditur, i gjykatës së shkallës së dytë, nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë, në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka vlerësuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, përkitazi me ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, dhe të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Me dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes Kolektive të sipër cekur, parashihej, që lidhur me “shpërblimet jubilarë” i punësuarit ka të drejtë në shpërblim jubilar dhe atë për 10 vite përvojë pune pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page të tij, për 20 vite përvojë, në vlerë të dy pagave mujore të tij, për 30 vite përvojë, në vlerë të tri pagave mujore të tij, i cili shpërblim paguhet brenda një muaji ” dhe në kontekstin e mësipërm, pra, me arritjen e vitit jubilar, krijohet e drejta, e cila nëse nuk është përmbushur në mënyrë vullnetare në afatin prej një muaji, lind e drejta që të kërkohet realizimi i saj në rrugë gjyqësore.

Me dispozitën e nenit 2 të Ligjit të Punës, parashihet se “ Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”. Me dispozitën e nenit 90 par.4 të këtij ligji parashihet se “ Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet ”. Kurse, me par.5 të këtij neni, parashihet se “ Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive ”, gjë që këtu, në këtë çështje juridike, nuk është rast, ndërkohë që, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, nuk ka efekt retroaktiv. Gjithashtu duhet theksuar se me dispozitat e Ligjit të sipërpërmendur, nuk është paraparë e drejta e punëtorit për pagesën e shpërblimit jubilar dhe e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension të pleqërisë. Ndërsa, me dispozitën e nenit 77 të po të njëjtit Ligj, është paraparë që pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Nga këtu dhe në prani të rrethanave, fakteve si dhe nga arsyet e sipër përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, nga se vërtetë, në rastin konkret civil-juridik, mungon baza juridike, përkatësisht, baza ligjore, që pagat kontestuese jubilarë dhe ato përcjellëse për shkuarje në pension, t’i paguhen paditëses, nga ana e

të paditurës, nga se sikundër u theksua më lartë Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ishte në fuqi për tri vite, nga data 1.01.2015 deri 31.12.2017, si dhe duke marrë për bazë edhe vendimin e të paditurës nr..., dt.23.08.2019, sipas të cilit, veç tjerash, kërkohet që punëmarrësit të kenë plotësuar kushtin deri 31.12.2019, dhe që të kenë arritur përvojën e punës 10, 20 apo 30 vite, prej 1.01.2015 dhe në vazhdimësi, e që këtu, nga arsyet e sipër përmendura, nuk ishte rasti konkret me paditësen, ndaj, rezulton pathemelësia e kërkesëpadisë së paditëses, e nga këtu, edhe pretendimet e revizionit vlerësohen të pa paqëndrueshme.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.457/2024 datë 10.10.2024

Kryetar i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha